

**VENDIM**  
**Nr. 520, datë 12.6.2015**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË SIPËRFAQES TRUALL FUNKSIONAL, BRENDË TERRITORIT TË PRONËS NR. 906, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 7008, FAKULTETI TEORIK”, ME VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3 636.8 (tremijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë pikë tetë) m<sup>2</sup>, brenda territorit të pronës nr. 906, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për ndërtimin e rrugës nacionale automobilistike Transballkaniku Fier-Vlorë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të hiqen objektet dhe trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3636.8 (tremijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë pikë tetë) m<sup>2</sup>, nga objektet dhe trualli funksional i pronës nr. 906, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet vendimit, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

3. Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës së Forcave të Armatosura, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, të ndërtojë rrethimin, në kufijtë e rinj, të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer ato në gjendjen e tyre të mëparshme. Për këtë qëllim, të hartohet një aktmarrëveshje e përbashkët, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Komandës së Forcës Ajrore të Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Vendimi nr. 357, datë 29.4.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përdorim, pa shpërblim, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të objektit nr. 2, me dy kate, pjesë e pronës nr. 906, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik”, në Vlorë, shfuqizohet.

6. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

Planvendosja e Rep.Usht. 3331 Shkolla e Aviacionit Vlore (Prona nr.906)  
 "Sipërfaqja që preket nga projekti i rrugës Transballkanike"

sh. 1000

MIRATCHET  
 Komandant Forcës Ajrore  
 xhoni Mehmet METKO



Shpjeguesë:  
 Sipërfaqja që zë projekti Rrugës = 3636.8 m<sup>2</sup>  
 Kull repart

Shënim: Ky Plan vendosje i përgatit në statutin të shkollës me nr.1294/1 dt.19.02.2015 të SH.BUP.F.A-së.  
 Projekti i rrugës Transballkanike i ndihmon në planvendosjen e kësaj prona merr nga akti 11.02.13.06

Punuar Prill 2015

400.70

400.70

Shkalla 1 : 1000

400.70

2A

ZvD  
 Ark

Përgj.Sek. Ramiz HAXHILU